



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Ekstrakti i dëgjimit të përgjithshëm publik, mbajtur më datë 26.6.2025

Isa Rexha- Kryesuesi i fshatit Barilevë dhe Drenovc: - i ka disa kërkesa. Dëshiron ta dijë se cilës komunë i përket Barileva? Podujevës, Vushtrrisë, Obiliqit a po Prishtinës? Po i bie shkurt, Barileva i ka 32km rrugë të pa shtruara. Gjysma e Barilevës nuk ka kanalizim. Asnjë lagje në Barilevë nuk është ndriçuar. Të dalësh nga Lupçi, deri ku përfundon Raskova, është e pa pastruar. Është lagjja Kurtolli që nuk ka qasje në ujësjellës. Në lagjen Llumnica janë shpërngul gati një pjesë dërmuese. Lagjja Leci ose ka pronën ose i blejnë pronat dhe po kalojnë në Besi për shkak të infrastrukturës edhe Prurgovc. Rruga është e shtruar mirë, mirëpo nuk ka ndriçim. E vetmja punë që kanë bërë është Drejtoria e Shërbimeve Publike, i ka pastruar një hapësirë për varreza. Problemi kryesor që kam. Lagjja Kurti të kyçet në ujësjellës.

Kryetari: - tha, të gjitha këto probleme që i përmende ne i morëm shënimet, dhe do t'i shikojmë edhe me tregu mbrapa çka mundemi dhe çka nuk mundemi me bë. Mirëpo sa për informatë shtesë që po më duket që nuk e keni është që, se thatë që nuk është asnjë kaci, nuk është investu në Barilevë. E kemi bërë në Barilevë urën e re, parkun e ri, domethënë kemi po ashtu edhe projekte të ndryshme që tash unë po ua jap fjalën drejtorëve me tregu sa shumë faktikisht është investu në Barilevë, ndoshta si asnjëherë më parë, po asnjëherë nuk është boll.

Donika Çetta-drejtoreshë: - tha, sa i përket fshatit të Barilevës edhe Drenovcit. Vetëm në Barilevë janë dy parqe të mëdha. Njëri është tre hektarë, i përruar vitin e kaluar, tjetri te lagjja e Llumnicve është një hektar, domethënë me të gjitha elementet përcjellëse të këndeve rekreative, sociale edhe gjelbërimet. Gjithashtu, krahas parqeve jemi të gjithë të vetëdijshëm se edhe është kryer infrastruktura, për të arritur te parku i Llumnicës është bërë edhe rruga me kupëza të betonit, e gjithashtu edhe në lagjet e Barilevës, krahas parkut që është ndërtu.

Bekim Brestovci-drejtor: - tha, si Drejtoria e Shërbimeve Publike e përmendi vetë zotëri Rexha që e kemi bërë pastrimin në një terren bukur të madh i cili është i planifikuar për varrezë. Z. Rexha e dinë që aty kemi edhe pak rezistencë për me e shndërrua atë hapësirë në varreza. Nuk e kemi problem pastaj me u marrë me rrethojën, ndërsa sa i përket ndriçimit e kemi bisedu disa herë që tash jemi veç në implementim të një kontrate që fatbardhësisht Prishtinën e kanë me e bë më të ndriçuar se kurrë do herë më parë. Së shpejti kemi me fillu me shtrirjen e rrjetit në rrugën lidhëse “Ejub Statovci”, në rrugën “Xhevdet-Leci”, në rrugën “Smajl Nreca”, në rrugën “Ahmet Shala”, në rrugën “Vranina”, në rrugën “Mulla Ahmet-Çunaku”, në rrugën

“Fatmir-Leci”, në rrugën “Selman Uka”, “Arsim Ibrahim” dhe në rrugën “Ilirët”. E kemi trajtu edhe një çështje disa herë e që ka qenë zgjatja i linjës së autobusit deri tek lagjja Leci. Jam informuar sot prej shefit të sektorit mobilitetit që edhe ky vendim është tani më në zyrën ligjore dhe pritet që prej 1 korrikut me hy pastaj në shërbim.

Izet Sadiki-drejtor: - tha, unë jam drejtor i shëndetësisë dhe po dua me tregu që ne në fushën e shëndetësisë domethënë, nuk duhet me ditur Prishtinën. Domethënë Prishtina është një territor me hapësira të madhe, nuk munden me bë qasje të veçantë ndoshta për çdo vend. Ajo që kemi bërë me Barilevën është që me ato lokaliteti. Ne para dy viteve, e dinim në Bardhosh ka qenë Qendra e mjekësisë familjare, cila e ka punu domethënë vetëm 8 orë dhe pa laborator. Duke pas parasysh që ai territor tash është rritur edhe Barileva edhe fshatrat tjera, ne përveç që kemi ruajt ambulancën në Barilevë, e kemi bërë Bardhoshin me 12 orë, që domethënë mbasditë i me pas shërbime dhe kemi bë laborator për herë të parë. Por, do të jem i gatshëm domethënë në të ardhmen që shërbimet shëndetësore në këtë pjesë domethënë të forcohen me qëllim që pjesët e zonave rurale domethënë të kenë shërbime cilësore shëndetësore sikurse dhe në kryeqytet.

Sokol Havolli-drejtor: - tha, i kemi pas disa komunikime edhe në telefon me z. Rexhën, ku e kam ngritur edhe çështjen e kanalizimit. I kemi dërgu ekipet edhe janë duke e ndërtuar projektin sepse është e pamundur që të ndërhyret në projekt, sidomos që sipas informatave që i kam nga ekipet në terren. Prek edhe në çështje pronësore. Projekti për kanalizim, prek edhe në çështje të infrastrukturës tjetër, e cila është jashtë kompetencave të komunës. Mirëpo me gjithë atë edhe në aspektin e investimeve përgjatë këtij mandati, janë të paktën shtatë rrugë që janë shtruar në kuadër të fshatit Barilevë, sikur që është rruga “Arsim Ibrahim”, rruga “Ilirët”, rruga “Hashim Januzi”, rruga “Sadik Rustolli”, një krah i rrugës “Çlirimtarët” edhe rrugë në lagjen Llumnica e gjithashtu edhe në lagjen Gashi. Po ashtu ka pas edhe trajtim të varrezave bashkë dhe me drejtorit tjera, përveç ndërhyrjes ka pasur edhe trajtim edhe me kubëza, kështu që ka qenë një varg i investimeve.

Samir Shahini-drejtor: - tha, unë duhet të shtoj edhe një element, që në shkollën “Ali Kelmendi” në Barilevë për në total 324 nxënës sa ka shkolla tash, do të jemi në përgatitje në fakt që nga shtatori të fillon programi i mësimi tërëditor në këtë shkollë, si pjesë e shtatë shkollave të reja që kalojnë në mësim tërëditor nga ky shtator. Edhe kemi marrë një vendim të përbashkët edhe me kabinetin, që nga shtatori i këtij viti shkolla “Ali Kelmendi” jo vetëm që kalon në mësim tërëditor për ciklin një deri në pesë, por do të jetë një nga dy shkollat e vetme në Kosovë që kalon në mësim tërëditorë nga klasa e parë deri në klasën e nëntë.

Kryetari: - tha, unë edhe njëherë ju falënderoj shumë për kontributin tuaj si qytetar aktiv me informatat që i kemi. Gjithsesi të gjitha pikat që i keni marrë parasysh që e keni faktikisht prezantuar sot i marrim parasysh. Ne kemi bërë edhe në aspektin e zhvillimit rural edhe me Drejtorinë e Bujqësisë. Pra, ka prej perspektivave të ndryshme, ka pasur investime të shumta në Barilevë.

Donjeta Dragusha-drejtoreshë: - tha, sa i përket zhvillimit rural edhe përkrahjes në bujqësi, atëherë sigurisht që Barileva edhe njihet si trevë që është mjaft kultivuese. Mirëpo, po besoj që edhe përkrahja prej aspektit të komunës edhe Drejtorisë së Bujqësisë dhe zhvillimit rural nuk ka munguar. Unë mundem me thënë që vitin e kaluar vetëm në Barilevë kemi përkrah dhjetë fermerë me sera të ndryshme që kanë qenë serat të madhësisë prej pesë ari dhe serat të madhësisë prej dy ari. Po ashtu, kemi mbi tridhjetë fermerë vetëm në Barilevë dhe Drenovc që kemi përkrah me mekanizma të ndryshëm bujqësor. Fokusi ka qenë mjaft i madh, se nëse e

marrim parasysh që tridhjetë fermerë vetëm në Barilevë dhe Drenovc prej tanësisë së fermerëve të përkrahur, po besoj që është një numër bajagi i kënaqshëm për atë pjesë.

Dren Shahini- kryetar i lagjes Mati 1 Jugu: - rrugës “Muharrem Fejza” me rrugën lidhëse tha, se kjo lagje është më e populluara në Prishtinë me dendësinë më të madhe të ndërtimeve e rrjedhimisht me shumë probleme. Po dua me i specifiku, gjatë qeverisjes. Ju z. Rama, ne e kem përfunduar rekonstruktimin e rrugës “Muharrem Fejza”. Pjesën e parë, pjesa dytë ka mbetë e patrajtuar fare. Gjithsejtë si qeverisje i keni ndërtu edhe 4 rrugë brenda lagjes Ukshin Kovaqicin, Uran Ajeti, Afrim Gashi, Muhamed Qami, kanë përfunduar siç kanë përfunduar, por nuk janë finalizuar krejtësisht me ndriçim. Një ndër kryesoret që mundem me e cekë tani së voni, është problematika e fushë sportive në shkollën “Pavarësia” fusha e jashtme. E vetmja fushë tani dy vite ka mbet peng i një trafo si dislokimi i trafos. Pastaj, aneksi i shkollës “Pavarësia” e kemi fituar, por që finalizimi i saj nuk ka ndodhë. Nuk ka pranim teknik të atij aneksi. Stacioni jugu ka mungesë të theksuar të veturave.

Kryetari: - tha, nuk kam dëgjuar unë personalisht as drejtorët që ke kërkuar diçka personale, po ka qenë krejt për lagje. Edhe vetëm në këtë mënyrë po them mundemi me ecë përpara mirë e shpejt, duke pas një komunikim të qasshëm, një komunikim transparent mes qytetarëve, mes institucionit. Ky është institucioni i qytetarëve edhe këtu jemi për, pikërisht për me i kryer shërbimet ndaj qytetarëve. Ndoshta me u ndërlidhë qasja ime gjashtëmujorëshe e para në Muharrem Fejza, që kam qenë krejt kohën aty e keni pasë një rast super urgjent. Ka qenë një katastrofë totale urbane me Muharrem Fejzën. Prishtina vetëm po rritet çdo vit që është një pozitivitet është një energji e mirë sepse qytetet në rritje e kanë tregojnë që diçka pozitive është duke ndodhë. Në lagjen Mati 1, kemi bërë punime të shumta të cilat kisha pasur dëshirë me i lënë mundësinë drejtorëve me i përmend vetëm sa për ilustrim që e dimë që i vyen, e dimë që densiteti është super i lartë. Mendoj se kemi bërë një investim shumë më të madh në relacion edhe me disa pjesë tjera të kryeqytetit, që kjo domethënë jemi mundu me iu afruar asaj aspektit të densitetit, aspektit të pagimit të tatimeve në relacion me investimet në lagjen ku jeton. Po ashtu edhe puna e shërbimit të trafikut ideja e nënshkrimit të 26 kontratave me sektorin privat edhe heqja e domethënë digjitalizimi i procesit është pikërisht për me mundësi një shërbim më të mirë. Edhe në këtë jemi në proces, pra e kemi shty përpara. E kanë një periudhë kohore 12 mujore.. E kanë në bazë të kontratës edhe për me i ndrru autobusët, po me marrë autobus të ri ose autobus që nuk janë më të vjetër se 8 vite. Domethënë, ne kemi thënë ju kryene shërbimin e mirë ndaj qytetarëve, ne merremi me bileta si kryeqytet, pra ata mos me pas me u pagu për kilometër. Pra, kjo gjithsesi kisha pasur dëshirë me na dhënë informata të drejtpërdrejta. Ndoshta numrin e tabelës, shoferin edhe me ditë saktësisht kush nuk po e shërben qytetarin, ashtu siç e ka në kontratë, ashtu siç ne e kemi synim për kryeqytet.

Sokol Havolli-drejtor: - tha, për shkak të densitetit shumë të lartë të banorëve, po edhe për shkak që fillimisht edhe vetë rruga “Muharrem Fejza” ka qenë në gjendje shumë të keqe, ndërsa është trajtuar në këtë mandat e po ashtu, janë duke u krijuar edhe alternativa tjera të jashtëzakonshme, sepse ajo rrugë përkundër cilësisë së mirë që është bërë gjatë kësaj periudhe, është e pamundur të absorbojë gjithë atë nivel të trafikut dhe të komunikacionit. E deri edhe te problemet jashtëzakonisht të mëdha sikur që ka qenë edhe kundërmimi që ka ardhë prej kolektorit hapur që ka qenë në pjesën e segmentit katërt të rrugës “B”, që është duke u ndërtuar aktualisht. E që ajo në masë të madhe e ka lehtësua edhe jetën, sidomos banorëve të rrugës “Muhamed Çami” edhe rrugës së “Ahmet Gashi”, që praktikisht e kanë pasë të pamundur edhe t’i hapin dritaret e tyre. Mirëpo me vazhdimin e rrugës “B” në drejtim të rrugës “A”. Kjo përveç që, po e krijon një infrastrukturë e cila ka me lehtësua, komunikimin e rrugës së “Muharrem

Fejza” me pjesën tjetër të qytetit me krijuar disa alternativa të komunikimit e kështu me radhë. E përmenda rrugën "Muhamed Çami", që është bërë një trajtim jashtëzakonisht i mirë. Ani pse ajo çështja pronësore atje në fund ende nuk e ka lidh në mënyrë adekuate me rrugën “Malush Kosova”. E kemi të trajtuara në mënyrë shumë të mirë edhe rrugën "Ahmet Gashi" që është një rrugë më herët sesa rruga “Muhamed Çami”. Është e trajtuar në mënyrë adekuate ai segment aty i rrugës “Holger Petersen” deri tek udhëkryqi i spitalit edhe vazhdimi andej nuk është në gjendje të keqe, por udhëkryqin e dëmtuar prej peshave të rënda do e trajtojmë, në njërin prej vikendeve me qëllim që me evituar dhe shkaktimin e trafikut në atë pjesë. Kemi rikuperuar edhe rrugën “Malush Kosova”. Përveç projektit të rrugës “A” dhe të rrugës “B”. Po kemi me pas një lëshim të drejtëpërdrejtë edhe që ka me pas një komunikim të jashtëzakonshëm komplet Bregu i Diellit, Velania, Prishtina e Re, përmes një rruge me standarde shumë të larta. Kemi pas edhe dhjetëra intervenime tjera në përmirësimet e dëmeve që shkaktohen qoftë prej peshave të rënda qoftë edhe prej faktorit të sezoneve të shiut, borës e kështu me radhë, që është shkaktar ereziv kryesor i dëmtimit edhe të rrugëve. Dua ta bëjmë një trajtim profesional, që kur ta bëjmë një rrugë ta zgjidhim problemin në mënyrë të plotë për gjithë segmentin e rrugës. E po ashtu disa ndërhyrje do i realizojmë gjatë tri-katër jave të ardhshme ose pesë jave të ardhshme në rrugën "Uran Ajeti", "Ukshin Kovaçica", "Ahmet Korenica", "Teodor Muzaka" dhe sigurisht jemi duke analizuar me kryetarin edhe rrugën "Bedri Berisha", që ka qenë përpara segment i rrugës “Ndue Perleshi” por që e ka një gjatësi shumë të madhe, por edhe ajo duhet ta ketë një trajtim të veçantë, duke fillu prej gjitha instalimeve nëntokësore, sepse shtresa asfaltet në fund të fundit është më e lehta të vendoset në këto rrugë.

Kryetari: - tha, tash vetëm kemi bërë këtë rrugën “A” me rrugën “B”, mirëpo rruga “A” e dinë që vazhdon rruga “Xhim Xhema” deri në Zllatar në atë pjesë. Kështu që paralelisht vazhdon edhe “A” edhe vazhdimi i dytë i rrugës "Muharrem Fejza" edhe ndërlidhja pastaj me këto qasjet anësore prej dy rrugëve për të krijuar sistem njëkajor që edhe me mundësua trotuare pastaj shtesë, se sot për fat të keq aty për shkak të densitetit aq të lartë njerëzit kanë probleme me parkingje, kanë probleme me trotuare, kështu që ne e kemi në proces pra krijimin e këtyre çështjeve njëkajore, që me krijuar edhe standarde të mira për këmbësorë për prind me fëmijë, kur edhe i lidhim dy rrugët me sistem njëkajor.

Samir Shahini-drejtor: - tha, një sqarim të shpejtë edhe të shkurt për trafo në fushën e sportit të shkollës, pavarësisht fushën e jashtme. Procedurë tenderimi është fillu përfundon brenda javës së parë të korrikut dhe sipas planit largohet trafo brenda korrikut. Ideja është që menjëherë pas kësaj të bëjmë edhe intervenimet, dhe jam plotësisht i bindur që kthehet në shfrytëzim para shtatorit për gjithë komunitetin.

Bekim Brestovci-drejtor: - tha, desha vetëm ti falënderohem Drenit, për krejt qasjen që e ke pas tepër konstruktive në këtë fazë, ku kemi pasur problemin më të madh në menaxhimin e mbeturinave e gjithashtu kërkim falje në emër tonë tek qytetarët për vonesa. Ndoshta po e shfrytëzoj rastin për të gjithë të tjerët edhe njëherë si informim që në energji elektrike, në shtrirje të rrjetit dhe në mirëmbajtje të energjisë elektrike. Nuk është bërë asnjëherë në Prishtinë aq sa do bëhet këtë vit. E kemi një prej kontratave më të mira që ka pasur ndonjëherë kryeqyteti e që parasheh ndërrimin e të gjithë poqëve elektrik në tërë kryeqytetin, që janë përafërsisht mbi 20 mijë. Janë vendosur mbi 8 mijë poça ndriçues në territorin e Prishtinës dhe se është në përgatitje edhe një porosi e dytë me 12-13 mijë poça shtesë. Ai theksoi se Prishtina do të jetë më e ndriçuar se kurrë më parë. Në lidhje me ndriçimin publik ai informoi se aktualisht gjashtë ekipe janë në terren duke punuar me intensitet të lartë, dhe rezultatet e këtyre angazhimeve do të jenë të dukshme së shpejti. Ai përmendi se rruga “Muharrem Fejza” dhe rrugë të tjera

periferike të cilat ndodhen në listën e prioriteteve për intervenim, tashmë janë pjesë e planifikimit për zgjerim të rrjetit të ndriçimit dhe ndërhyrje infrastrukturore. Lista e rrugëve për intervenim është shumë e gjatë dhe mbulon zona të shumta të kryeqytetit. Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, drejtori Brestovci përmendi se është planifikuar inspektim dhe ndërhyrje së bashku me përfaqësuesin lokal Drenin, duke filluar nga lagjja Dardania dhe më pas Ulpiana e rruga “Muharrem Fejza”. Qëllimi është të identifikohen dhe shënohen të gjitha nevojat për secilën lagje në mënyrë që të implementohen masat përkatëse me prioritet të përcaktuar.

Lulzim Fushtica-drejtor: - përshëndeti kryetarin dhe të pranishmit duke falënderuar në veçanti Drenin për kontributin në identifikimin e problemeve në lagjen Mati 1, ku ai tashmë ushtron funksionin e kryetarit të këshillit lokal. Ai theksoi se Mati 1 është një nga lagjet më të mëdha në Prishtinë me një dendësi të lartë banorësh, gjë që sjell edhe sfida të shumta në aspektin e sigurisë publike. Sipas tij, Stacioni Policor i Jugut, që mbulon këtë zonë është më i ngarkuari në gjithë Kosovën për nga numri i rasteve. Ai informoi se janë në fazën përfundimtare të hapjes së një stacioni të ri policor në Hajvali, por paralelisht po punohet edhe për hapjen e një stacioni të dedikuar për Mati 1. Janë në proces të identifikimit të hapësirës së përshtatshme për këtë qëllim dhe planifikohet që takimi i ardhshëm me përfaqësuesit lokalë të mbahet brenda javës që vjen ai nënvizoi se disa nga çështjet e ngritura janë në proces zgjidhjeje dhe ka besim që gjatë këtij viti do të adresohen. Ai theksoi rëndësinë e veçantë të sigurisë për lagjen Mati 1, për shkak të numrit të madh të lokaleve, banorëve dhe objekteve publike, duke paralajmëruar hartimin e një plani konkret për trajtimin e të gjitha çështjeve të evidentuara.

Izet Sadiku-drejtor: - iu drejtua Drenit me një falënderim për bashkëpunimin dhe angazhimin, duke thënë se tashmë i takon atij zyrtarisht një mirënjohje për angazhimin dhe komunikimin e vazhdueshëm. Ai konfirmoi se kanë bashkëpunuar disa herë për çështje të shëndetit publik në lagjen Mati 1, përfshirë dezinfektimin dhe deratizimin. Ai sqaroi se lagjja Mati 1 është zonë me rrezikshmëri më të lartë për brejtës, kryesisht për shkak të zhvillimit të hovshëm urban dhe ndërtimit të madh që ndodh atje. Ai informoi se deratizimi është rinisur në nëntor të vitit 2023, për herë të parë pas tri vjetësh dhe është kryer faza pranverore. Ai shtoi se procesi bëhet në dy faza pranverë dhe vjeshtë, por do të shikojnë mundësinë që të ketë një fazë shtesë në lagje për shkak të gjendjes specifike. Në përfundim, ai siguroi se Drejtoria e Shëndetësisë do të angazhohet përsëri për të ndërhyrë në kohë dhe në mënyrë të koordinuar me përfaqësuesit lokalë për ta përmirësuar situatën.

Osman Billaca- kryesues i diskutimit: - informoi se mbledhja po transmetohej drejtpërdrejt përmes livestream-it dhe u bënë thirrje qytetarëve që t'i dërgojnë komentet dhe pyetjet përmes email-it, duke përmendur tri kërkesa të ardhura nga qytetarët:

1. Ylli Mehmeti- kërkoi rritjen e koeficientit të ndërtimit për zonën Mati 2 – çështje që i takon Drejtorisë së Planifikimit.
2. Anduena Beqiri- banore në kompleksin R&R Rukolli në rrugën “Ndue Përleshi” në Mati 1, kërkoi reagim për zhurmën që shkakton një palestër kickbox-i në fund të lokalit të saj – kjo çështje i takon Drejtorisë së Inspeksionit.
3. Bekim Hamiti- nga Bërnica e Poshtme kërkoi shtrimin e rrugës “Kreshnikët” (300 metra) dhe shtimin e linjës së autobusit 3B që të operojë çdo 30 minuta, nga ora 06:00 deri në 22:00. kërkoi që drejtorët t'i marrin parasysh këto kërkesa dhe t'u përgjigjen edhe zyrtarisht nëpërmjet email-it.

Avdi Aliu- kryetar i Këshillit Lokal të Keqekollës: - në fjalën e tij theksoi se ndonëse banorët në zonat rurale janë më pak në numër, ata kanë nevoja të mëdha infrastrukturore. Ai përfaqësoi banorët e katër fshatrave; Keqekollë, Ballaban, Nishec dhe Prapashticë.

Ai falënderoi institucionet për investimet e bëra, por nënvizoi se ato nuk janë të mjaftueshme duke theksuar se disa rrugë janë pothuajse të pakalueshme. Banorët, sipas tij kërkojnë të paktën zhavorr ose greder për rrafshim të rrugëve. Ai përmendi se edhe vetë ka hasur vështirësi të mëdha me veturë për të kaluar në disa prej rrugëve. Në lidhje me arsimin Aliu propozoi një reformë, për të tubuar nxënësit nga shkolla me numër të vogël në një vend të përbashkët, për të ofruar arsim cilësor. Ai gjithashtu ngriti edhe çështjen e mbledhjes së mbeturinave në këto zona, duke pyetur nëse orari i grumbullimit është tashmë çdo dy javë dhe nëse do të kthehet në çdo javë, siç ishte më parë.

Sokol Havolli-përfaqësues i Drejtorisë së Investimeve Kapitale: - falënderoi përfaqësuesit për diskutimet dhe vlerësimet. Ai theksoi se për shkak të shtrirjes së madhe territoriale puna është ndarë me kolegët dhe se prioritetet në fshatra janë identifikuar sipas nevojave të banorëve dhe shtëpive. Ai përmendi konkretisht ndërhyrjen në fshatin Nishefc, ku ka pasur ndërtim të ri dhe nevojë për rrugë të reja. Sipas tij, zhavorrimi që po realizohet është i thellë dhe i qëndrueshëm, duke shërbyer si bazë për asfaltim në të ardhmen. Ai konfirmoi se prioritetet e listuara nga përfaqësuesit lokalë do të trajtohen dhe se ndërhyrjet do të vazhdojnë edhe në rrugët e asfaltuara që kanë nevojë për riparim.

Sami Shahini-drejtor i Arsimit: - vuri në pah se gjatë mandatit të tij kishte vizituar pothuajse të gjitha shkollat në zonën e Gollakut dhe se ishte bërë një analizë për implementimin e mësimi tërëditor në disa shkolla me numër të vogël nxënësish. Ai konfirmoi se shkollat në Grashticë, Mramor dhe Llukar do të kalojnë në sistemin e mësimi tërëditor nga shtatori. Sipas tij kjo reformë do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit, do të ofrojë shujta për nxënësit dhe do të stimulojë qëndrimin e banorëve në fshat.

Kryetari: - theksoi se Gollaku është pjesë e rëndësishme e strategjisë 8-vjeçare të zhvillimit rural. Ai e cilësoi rajonin si një zonë me potencial të madh për turizëm malor dhe agroturizëm. Ai bëri të ditur se është përfunduar masterplani për zhvillimin e turizmit në bashkëpunim me organizatën Swisscontact dhe se ka interes nga sektori privat për investime. Krahës kësaj, ai vuri theksin të përmirësimi i infrastrukturës dhe krijimi i mundësive për banorët që të mos largohen nga fshatrat, por të jetojnë në ndërveprim me natyrën dhe të kenë kushte më të mira jetese.

Avdi Aliu- kryetar i Këshillit Lokal të Keqekollës: - ritheksoi se prioritet për zonën janë rrugët të cilat janë në gjendje shumë të rëndë. Ai kërkoi vizitë të përbashkët në terren me drejtorin për të parë nga afër rrugët që janë lënë pas dore në Keqekollë. Ai përmendi se dy rrugë janë nisur që nga viti 2013, por janë ndërprerë dhe nuk janë trajtuar më. Ai konfirmoi se ka dorëzuar dhjetëra kërkesa zyrtare për përfundimin e tyre dhe shprehu shqetësimin se pavarësisht punëve të bëra në fshatra të tjera, Keqekolla nuk është trajtuar si duhet.

Mjalta Lezi - kryetare e Asamblesë së Fëmijëve të Kryeqytetit: - përshëndeti drejtuesit komunal dhe shprehu falënderim për bashkëpunimin e mirë me institucionet, në veçanti me kryetarin dhe drejtorët komunalë. Ajo theksoi se fëmijët nuk janë vetëm e ardhmja por edhe pjesë aktive e së tashmes, duke ndikuar në ndërtimin e një të ardhme më cilësore përmes pjesëmarrjes së tyre. Në fjalën e saj, Lezi theksoi rëndësinë e arsimit si shtyllë bazë për të ardhmen e fëmijëve dhe përgëzoi për reformat e ndërmarra në këtë sektor, duke përmendur mësimin tërëditor si një shembull që ka nxitur motivimin e nxënësit dhe ka përmirësuar përfshirjen në aktivitete të ndryshme shkollore. Ajo kërkoi që vëmendja të mos fokusohet vetëm te shkollat qendrore, por edhe te ato periferike dhe në zonat rurale të Prishtinës. Lezi përmendi përmirësimin e infrastrukturës shkollore, por vuri në dukje se digjitalizimi mungon në disa shkolla. Kërkesat përfshinin pajisjen me tabela të mençur (smartboard) dhe dollapë personale, që kanë rezultuar

shumë efikase në disa shkolla si “Pjetër Bogdani”. Asambleja e Fëmijëve kishte përgatitur një dokument më 23 qershor me kërkesa konkrete për secilën shkollë. Ndër çështjet e tjera të ngritura ishin:

- Rritja e numrit të psikologëve shkollorë, duke e lidhur drejtpërdrejt mirëqenien mendore me suksesin arsimor.

- Shtimi i asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta, duke theksuar rastin ku vetëm dy asistente nuk mjaftojnë për një numër të madh fëmijësh.
- Prania e mjekut në objektet shkollore për të adresuar urgjencat shëndetësore.
- Futja e orëve të programimit si Python dhe JavaScript në kurrikul, për të përgatitur nxënësit për të ardhmen digjitale.
- Binjakëzimi i shkollave me institucione arsimore evropiane për shkëmbim kulturor dhe arsimor.
- Sigurimi i transportit të rregullt për fëmijët që jetojnë larg shkollave.
- Rritja e sigurisë në shkolla dhe prania e policisë civile.
- Zbatimi i programeve për orientim në karrierë për nxënësit e klasave të nënta.

Në fund, Lezi ngriti çështjen e rishikimit të testit të arritshmërisë, duke sugjeruar që, edhe pse është në kompetencë të Ministrisë së Arsimit, komuna mund të ndikojë në rishikimin ose heqjen e tij pasi shpesh nuk reflekton realisht arritjet e nxënësve dhe ndikon negativisht në motivimin e tyre për të vazhduar në shkollat e dëshiruara. Fjalimi u përmbyll me gatishmërinë për të dorëzuar një dokument të plotë me të gjitha kërkesat dhe propozimet nga Asambleja e Fëmijëve. Theksoi se nuk do t'i kishte përmendur shkollat në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ajo sqaroi se do ta kishte dërguar kërkesën direkt te drejtori i arsimit, pasi kërkesat që u përmendën përfaqësojnë të gjitha shkollat. Ajo nuk kishte pyetje konkrete, përveç kërkesave shtesë që vijnë nga Asambleja e Fëmijëve.

Kryetari: - falënderoi Mjaltën për paraqitjen e saj dhe u shpreh krenar për rininë e mrekullueshme të Kryeqytetit. Ai e vlerësoi qasjen konstruktive të saj dhe të Asamblesë së Fëmijëve ndaj nevojave të nxënësve dhe të qytetit. Kryetari theksoi rëndësinë e investimeve në rini nga çerdhet deri në shkollat e mesme, duke theksuar transformimin dhe digjitalizimin e sistemit arsimor si prioritet. Për detajet ia kaloi fjalën drejtorit të arsimit.

Samir Shahini - drejtor i Arsimit: - e falënderoi Kryetarin dhe Mjaltën për angazhimin dhe e vlerësoi fjalimin e saj si dëshmi që puna e drejtorisë po ecën në drejtimin e duhur. Ai përmendi se drejtorja menaxhon mbi 70 objekte arsimore, 3,100 punëtorë miliona euro buxhet dhe mbi 40,000 nxënës. Sipas tij, energjia dhe motivimi vijnë pikërisht nga nxënësit. Samiri theksoi se bashkëpunimi me Asamblenë e Fëmijëve është thelbësor për përmirësimin e kushteve në shkolla. Ai pranoi se një pjesë e kërkesave të parashtruara janë të ndërlydhura me kompetenca të Ministrisë së Arsimit, si numri i asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta dhe psikologëve, por edhe pse Ministria nuk i përfshin këto në kuadër të shkollave komuna ka bërë përpjekje shtesë, duke ofruar shërbime logopedike në disa shkolla përmes një bashkëpunimi me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale. Samiri përmendi gjithashtu se këtë vit do të shtohen edhe 10 asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta para muajit shtator, por pranoi se numri ende nuk është i mjaftueshëm. Sa i përket teknologjisë, ai bëri të ditur se shumë shpejt do të nënshkruhet një kontratë për furnizim me tabela digjitale për disa shkolla të tjera, me qëllim që mbulimi të bëhet vit pas viti deri në shkallë të plotë. Ndër investimet e rëndësishme, ai përmendi ndarjen e shkollave fillore nga ato të mesme të ulëta, si dhe kalimin në mësim tërëditor sipas cikleve, proces që sipas tij, ka qenë i pritur bashkë me nxënësit si Mjalta. Në

përmbyllje Samiri tha se mbetet për t'u diskutuar më tej orientimi në karrierë dhe projektet për binjakëzim me shkolla të tjera përfshirë bashkëpunimet me qytete si Tirana dhe shteti i Ajovës. Ai premtoi informim të vazhdueshëm dhe e mbylli fjalën duke falënderuar Mjaltën dhe Asamblenë e Fëmijëve, duke konfirmuar një takim të ardhshëm për diskutime të përbashkëta.

Adelina Salihu - përfaqësuese nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale: -, falënderoi Kryetarin, kolegët dhe qytetarët për pjesëmarrjen në diskutimin publik. Ajo theksoi rëndësinë e dëgjimit të qytetarëve dhe përmendi disa prej iniciativave të ndërmarra për fëmijët në kushte të pafavorshme ekonomike. Ndër to, veçoi ofrimin e kurseve të notit pa pagesë për fëmijë të skenës sociale për tre muaj rresht, me qëllim që edhe ata të kenë përvoja të barabarta me bashkëmoshatarët e tyre. Përveç kësaj, ajo përmendi subvencionimin e fëmijëve në strehim familjar dhe mbështetjen financiare për familjet kujdestare. Një tjetër iniciativë e përmendur ishte qendra ditore për fëmijët në situatë rruge, që ofron kohë cilësore dhe ndërhyrje për t'i larguar nga lëmosha. Ajo theksoi se ndonëse shumë nga këta fëmijë vijnë nga Fushë Kosova, si kryeqytet, Prishtina ka përgjegjësi për secilin që ndodhet brenda saj.

Kryetari: - theksoi nevojën urgjente për më shumë psikologë dhe mjekë në shkolla, duke nënvizuar se kërkesat janë bërë vazhdimisht në nivel qendror por mbeten të paplotësuara. Ai shprehu përkushtim që të ushtrohet presion shtesë institucional, pasi investimet kryesore duhet të drejtohen tek shkollat dhe rinia.

Lulzim Fushtica - drejtor i Sigurisë dhe Emergjencave: - e falënderoi Mjaltën për angazhimin dhe njoftoi se strategjia e re për sigurinë në shkolla është përfunduar në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit. Strategjia do të fillojë së zbatuari në shtator dhe përfshin përmirësime në sigurinë fizike, emocionale, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe trajtimin e bullizmit.

Elirjeta Beka: - përfaqësuese nga Rrethi i Grave të Kosovës, njoftoi se janë në fazën përfundimtare të një hulumtimi mbi transportin dhe infrastrukturën në Prishtinë nga një perspektivë gjinore. Ajo deklaroi se janë analizuar dokumentet strategjike dhe buxhetore të komunës, trafiku urban dhe rrugët duke nxjerrë disa rekomandime paraprake. Ato përfshijnë shtimin dhe mirëmbajtjen e korsive për biçikleta dhe pllakat taktile për personat me shikim të dëmtuar. Gjithashtu, kërkoi që Komuna të shtojë aneksin e buxhetimit gjinor në uebfaqe dhe të japë përgjigje sapo të pranohet hulumtimi për shqyrtim.

Kryetari i Komunës: - informoi se është drejt përfundimit Projekti i ristrukturimit të trafikut urban, në bashkëpunim me kompaninë ndërkombëtare ARUP, një ndër më të mirënjohurat në këtë fushë në nivel global. Ai përmendi se komuna po menaxhon mbi 8.2 milionë kilometra qarkullim rrugor në territorin e kryeqytetit dhe se tashmë janë në funksion 26 kontrata me operatorë privatë që po e bëjnë shërbimin më të qasshëm dhe më të lirë për qytetarët. Një prej përfitimeve të drejtpërdrejta është bileta e integruar, e cila ndihmon familjet të kursejnë deri në 200–300 euro në muaj. Sa i përket korsive për biçikleta, Kryetari tha se po punohet intensivisht për zgjerimin e tyre, sidomos në zonat që lidhin qendrat urbane me hapësirat e gjelbra si “Gërmia” dhe “Parku i Kalabrisë”. Ai e pranoi se infrastruktura në disa zona është pengesë, por përpjekjet janë të vazhdueshme. Për pllakat taktile për personat me të pamur, Kryetari njoftoi për një bashkëpunim me Ambasadën e Zvicrës përmes Elvana Shalës dhe për plane konkrete për zëvendësim dhe instalim të ri, duke kërkuar mbështetje shtesë nga Banka Botërore. Qëllimi është të krijohet një Prishtinë gjithëpërfshirëse dhe e qasshme për të gjithë qytetarët.

Sabedin Hasani: – Kryetar i Këshillit Lokal Qendër, falënderoi kryetarin dhe drejtorët për disa prej punëve të kryera në lagjen “Qendër” dhe paraqiti një sërë kërkesash dhe rekomandimesh nga banorët:

Rruga "Sylejman Vokshi" është zgjidhur problemi 13-vjeçar me infrastrukturën nëntokësore, por kërkohet rregullimi i sipërfaqes dhe ndriçimi në pjesën e garazheve të vjetra. Garazhet e vjetra: kërkohet konsultim me banorët për mundësinë e rrënimit ose rikonceptimit të tyre. Parkingjet në Zonën Qendër: pas një aktgjykimi të fundit, është rikthyer tollovia, propozohet regjistrimi i banorëve dhe pajisja me kartela, për kontrollin nga policia deri në riaktivizimin e "Prishtina Parking". Ndërtesat A, B, C, D në rrugët "Sylejman Shiroka" dhe "Nurie Zeka": kërkohet vlerësim i mundësisë së rrënimit dhe ndërtimit të objekteve më funksionale në të njëjtën hapësirë, ose përmirësim i pamjes së jashtme për të ruajtur imazhin e qytetit. Tunelet në zonën qendër: kërkohet ndriçimi dhe molerimi i tyre për rritje të sigurisë. Institucioni Parashkollor "Buzëqeshja", objekti aktual është i vjetër dhe hapësira nuk është e mjaftueshme, kërkohet ndërtimi i një objekti të ri. Fushë sportive në rrugën "Hajdar Dushi", banorët kanë bërë disa herë kërkesa të shoqëruara me nënshkrime, fushat ekzistuese janë të pamjaftueshme. Parqet e lodrave në Zonën Qendër, janë ndërtuar nga komuna, por disa janë dëmtuar, kërkohet mirëmbajtje. Probleme me kanalizimin në lagjen Ish-"Ramiz Sadiku", rrezik për përmbytje në rast të reshjeve të mëdha. Nevoja për zyrë të qëndrueshme të Bashkësisë lokale Qendër, kërkohet ndarje e hapësirës zyrtare në ndonjërin prej objekteve ekzistuese të komunës së vjetër ose alternativa të tjera. Beneficione për kryetarët e këshillave lokale: është kërkuar shqyrtimi i mbështetjes financiare dhe logjistike për këtë kategori, duke përmendur mungesën e beneficioneve për shëndetësi, transport etj. Falënderime për punët e realizuara në Zonën Qendër: Zbatimi i mësimi tërëditor, bileta e integruar e trafikut urban, ulja e ndjeshme e zhurmës në zonat qendrore (p.sh. rr. "Rexhep Luci", rr. "Fehmi Agani"), trajtimi i qenve endacakë, transformimi i rrugëve "2 Korriku" dhe "Rexhep Luci", vendosja e qezmeve dhe ulëseve të reja në sheshe, përmirësimi i mirëmbajtjes së parqeve dhe fontanave, vendosja e kamerave të sigurisë, ndriçimi digjital i shesheve.

Kryetari: - falënderoi Sabedinin për qasjen e balancuar, duke vlerësuar përmendjen e sukseseve krahas sfidave. Ai e konsideroi këtë si një formë stimulimi pozitiv për ekipet drejtuese që të vazhdojnë me përkushtim punën për qytetarët. Fjalën e radhës ia kaloi Drejtorit Sokol Havolli, për të vijuar me përgjigje ndaj çështjeve të ngritura.

Sokol Havolli: - duke falënderuar kryetarin, për intervenimet në rrugën "Sylejman Vokshi", tha se projekti është realizuar vitin e kaluar dhe ka pasur ndikim pozitiv në lagje, aktualisht po vazhdojnë punimet për ndërtimin e një muri nivelizues dhe përmirësimin e hyrjeve tjera, në bashkëpunim me banorët, ndërsa rruga "Hajdar Dushi" është përmendur si një rrugë me sfida të mëdha infrastrukturore. Aty nevojitet një projekt i detajuar për instalime nëntokësore dhe riorganizim të qarkullimit, pasi qarkullimi aktual është jofunksional dhe shkakton bllokime, por që do të shpallet kërkesa për dizajn dhe më pas do planifikohet buxhet për investim të plotë, ngjashëm me projektin në rrugën "Rexhep Luci". Një tjetër çështje është pjesa pas Pro Credit Bankës, është inspektuar disa herë nga ekipet komunale, nuk është identifikuar problem me kanalizimin, por me mungesën e drenazhimit të objektit, që shkakton grumbullim uji gjatë reshjeve atmosferike, gjithashtu po punohet me institucionet përkatëse për të adresuar problemin, varësisht nëse lidhet me pusetat e ujësjellësit apo jo. Tek rruga "Rexhep Luci", punimet janë drejt përfundimit dhe po vendosen pllaka travertin cilësore, si dhe po bëhen përpjekje për tejkalimin e bllokadave politike për të vazhduar punimet në vendet ku janë ndërprerë.

Donika Çetta – drejtoreshë: - ajo tregoi se në zonën qendër, ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me zonjën Violeta dhe palët tjera për të plotësuar kërkesat lidhur me hapësirat e gjelbërimit dhe këndet rekreative. Shumë prej tyre janë realizuar me sukses. Në vitin aktual do të bëhen ndërhyrje për rikthimin në gjendje të mirë të këndeve rekreative të vandalizuara. Në Prishtinë janë krijuar tri parqe të reja dhe dy kënde rekreative brenda Zonës Qendër. Po

kërkohen edhe zona tjera për hapje të parqeve apo gjelbërimit të vogël. Plani është që në shtator të rinovohet infrastruktura e dëmtuar dhe të rikthehet funksionaliteti i lodrave në këto hapësira.

Kushtrim Mushica - drejtor: - tha se në qendër të qytetit ka hapësira të vogla për fusha sportive, të cilat janë pak të kufizuara për t'u realizuar. Aktualisht po identifikohet një hapësirë që mund të përdoret për të ndërtuar të paktën një fushë sportive, si për shembull basketboll. Kjo është në fokus dhe do të ndërhyhet për ta realizuar atë.

Kryetari: - duke theksuar se qendra e qytetit të Prishtinës ka një densitet shumë të lartë dhe mungesë hapësirash të mëdha për zhvillim, megjithatë, po punohet për përmirësimin e kushteve brenda Pallatit të Rinisë, ku është duke u zhvilluar një proces që filloi disa vite më parë me mbështetjen e Bankës Evropiane për Investime, por u ndalua nga niveli qendror. Aktualisht, ky proces është rifilluar dhe pritet të sjellë përfitime të mëdha për Zonën Qendër. Paralelisht, është duke u punuar në projektin e “Gym vertikal” – hapësira sportive të vogla (rreth 50 x 50 metra), që janë pjesë e planeve zhvillimore të kryeqytetit. Këto hapësira do të mundësojnë zhvillimin e sporteve të ndryshme si futsal, basketboll, handboll, dhe potencialisht edhe pishina. Megjithatë, përparimi i këtyre projekteve po has në bllokada kryesisht politike, të cilat po pengojnë transformimin e hapësirave publike dhe shesheve të dizajnuara profesionalisht. Pavarësisht kësaj, puna vazhdon dhe lufta ligjore është në vazhdim për të siguruar realizimin e këtyre investimeve për të mirën e qytetarëve.

Jeton Berisha: - tregon se ka kërkuar ndryshimin e koeficientit të ndërtimit në lagjen “Kalabria” për një parcelë të caktuar. Fillimisht, u mor vendim për koeficient 1.5, pastaj e ndryshuan në 2.4, dhe më pas u kthye sërish në 1.5. Ky ndryshim u bë falë mundësisë së dhënë nga grupet e asamblistëve për ndryshim të koeficientit. Ka kërkuar të bëhet një propozim konkret, por kryetari thotë se duhet të propozojnë partitë kryesore (LDK, PDK, Vetëvendosje, AAK). Banorët në këtë zonë janë aty shumë para luftës dhe kanë trashëguar pronën nga paraardhësit, jo për biznes apo qëllime komerciale.

Arbër Sadiki – drejtor: - tregoj se ka pasur shqetësime lidhur me ndryshimin e koeficientit në një pjesë të planit të lagjes, që është pjesë periferike dhe jugperëndimore e planit. Në këtë zonë, sipas planeve ekzistuese, kishte hapësira të gjelbra dhe ndërtim individual me koeficient 0.8. Koeficienti është ndryshuar në 1.5 për ndërtim shumëbanesor, që është afërsisht dyfish më shumë. Ky ndryshim është bërë për të kompensuar hapësirat e parkut që mbeten aty dhe për të ruajtur balancën në përdorim. Pjesa ku është kërkuar ndryshimi është një zonë ku hapësira është e kufizuar dhe nuk mund të kalojë koeficientin 2.4 ose 2.6 për arsye fizike. Ndryshimi i planeve nuk bëhet lehtë dhe kërkon procedura ligjore, përfshirë periudha rishqyrtimi prej 4 ose 8 vjetësh. Nuk mund të ndryshohet vetëm me një vendim të Kuvendit, pasi duhet të respektohen procedurat ligjore dhe teknike.

Jeton Berisha: - duke thënë se i posedon 48 ari tokë, jo qindra hektarë dhe ka kthyer gjithë atë tokë. Problemi është pse tek ai është vendosur koeficienti 2.4, ndërsa e ka kërkuar të mbahet në 1.5. Ndonëse disa kanë hektarë tokë, ai është i pafajshëm që më është vendosur ky koeficient më i lartë, dhe kërkoj shpjegim për këtë ndryshim që po ndodh vetëm tek unë.

Bedri Hajzeri - përfaqësues i Bashkisë lokale të Koliqit: - ngriti disa çështje të rëndësishme gjatë takimit. Ai theksoi mungesën e asfaltimit në fshatin Koliq gjatë katër viteve të fundit dhe kërkoi avancimin e projektit për asfaltimin e rrugës Koliq-Keçekollë, një rrugë me rëndësi të veçantë që lidh dy fshatra dhe zonën kufitare. Gjithashtu, Hajzeri kërkoi shtimin e kilometrave të rrugëve me zhavor që duhet të trajtohen, duke sugjeruar që nga tri kilometra aktualisht të arrijnë në pesë kilometra. Ai nënvizoi nevojën për funksionalizimin më të mirë të bashkisë lokale, ambulancave dhe shkollave, duke shprehur shqetësimin se mungesa e stafit lokal dhe

kushteve të mira mund të dëmtojë zhvillimin e zonës dhe jetesën e banorëve. Në përfundim, Hajzeri apeloj për krijimin e kushteve që të mundësojnë jetesën dhe investimin e familjeve në këtë zonë, duke kërkuar përkrahje dhe veprime konkrete nga autoritetet.

Sokol Havolli - drejtor i investimeve kapitale: - tha se çështja kryesore lidhet me kapacitetin e buxhetit të alokuar për ndërhyrjet në rrugët fshatare. Prioritet u është dhënë fshatrave me banorë që jetojnë aty gjatë gjithë vitit, pasi distancat mes fshatrave janë shumë të mëdha dhe rrugët janë të shumta — rreth njëzet kilometra janë për të gjitha fshatrat e Prishtinës. Për momentin, po shqyrtohet edhe mundësia për rritjen e sasive të zhavorrit, me qëllim të trajtimit të rrugëve anësore që shpesh shërbejnë vetëm për një ose dy shtëpi. Këto rrugë kërkojnë ndërhyrje të vogla, për shembull nga 500 deri në 800 metra. Nëse kjo rritje e sasive realizohet brenda dy-tre muajve të ardhshëm, është e mundur që të përfundohet trajtimi i të gjitha rrugëve fshatare të Prishtinës me zhavorr. Ndërkohë, rrugët kryesore dhe ato në lagjet e mëdha të Gollakut janë të asfaltuara dhe në gjendje të mirë.

Kryetari: - falenderoi dhe shpjegoi se dëshiron të lidhet me situatën në Koliq, ku gjendja kërkon trajtim urgjent, gjë që edhe masterplani i zhvillimit të Gollakut e përfshin. Ai theksoi se pavarësisht që këto ndërhyrje janë në proces, problemi kryesor mbetet buxheti. Përmend sfidat me të cilat përballlet kryeqyteti, veçanërisht bllokimin e buxhetit të vitit 2025 për zhvillimin e rrugëve në zonat rurale, përfshirë Koliqin, edhe pse ky buxhet është miratuar nga asambleja në dhjetor të vitit të kaluar. Ai theksoi se, përkundër këtyre vështirësive, po vazhdojnë t'i shtyjnë përpara proceset dhe e konsideron Koliqin si një vend turistik me natyrë të mrekullueshme, që është pjesë e projekteve për t'u zhvilluar. Ai përfundoi duke kërkuar mirëkuptim, duke theksuar se edhe pse me “duar të lidhura”, po punojnë përpara.

Durim Berisha nga klubi futbolistik Barileva: - ka shprehur shqetësimin lidhur me gjendjen e infrastrukturës së stadiumit të Barilevës. Ai ka theksuar se prej tre vitesh nuk është zhvilluar asnjë aktivitet kampional në këtë stadium. Duke përfaqësuar fshatrat nga Besija deri në Tenezhdoll dhe me rreth 100 fëmijë aktivë, ai dëshiron të dijë se çfarë masash do të ndërmerren për përmirësimin e stadiumit dhe ku qëndron problemi aktual. Ai përmendi gjithashtu se në vitin 2022 ishte ndarë një buxhet prej 50 mijë eurosh për infrastrukturën e stadiumit, por deri më tani nuk ka marrë asnjë përgjigje lidhur me realizimin e këtyre investimeve.

Kushtrim Mushica- drejtor: - Durimin e përgëzoi thellësisht për angazhimin e tij si një nga drejtorët ose punëtorët sportiv, i cili ka bërë një rrugëtim të vështirë për të rikthyer klubin e Barilevës pas një periudhe pushimi, duke rigjallëruar shpirtin dhe dëshirën e futbollistëve për të luajtur futboll. Përkrahja nga Drejtoria e Sportit nuk ka munguar dhe do të vazhdojë, megjithëse çështja e pronësisë së stadiumit është sfidë kryesore dhe nuk është nën kompetencën direkte të Drejtorisë së Sportit. Janë zhvilluar diskutime në Kuvendin e Komunës së Prishtinës dhe në seancat e asamblesë, ku është shfaqur vullneti i qartë për ta zgjidhur këtë problem, i cili ka qenë një shqetësim i përbashkët. Çështja pronësore është duke u trajtuar në mënyrë të duhur dhe është kërkuar që të avancohen hapat për zgjidhjen e saj në kohën e duhur, në mënyrë që investimet të mund të realizohen sa më shpejt. Ka pasur propozime për ndryshimin e lokacionit dhe janë mbajtur takime me drejtorin e pronës, ku është kërkuar që në takimet e ardhshme të jetë prezent edhe Drejtoria e Sportit, për të adresuar edhe nevojat e fushës së futbollit. Përveç buxhetit prej 50 mijë eurosh që është planifikuar, ekziston edhe një buxhet tjetër rreth 200 mijë euro që presin të përdoren për investime, të cilat mund të realizohen vetëm pasi të zgjidhet çështja e pronës. Drejtoria e Sportit dhe Komuna e Prishtinës janë të gatshme të bëjnë investimet e nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur.

Sabetin Berisha - kryetar i Këshillit Lokal të Llukarit: - ka përmendur fillimisht falënderime për qeverisjen lokale të Komunës së Prishtinës, duke theksuar se është bërë një

punë e mirë. Ai ka theksuar se në kryeqytet janë trajtuar tema të ndryshme, veçanërisht në Bashkinë lokale të Llukarit dhe fshatrat përreth, të cilat ai përfaqëson. Megjithatë, ai ka ngritur disa kërkesa emergjente që kërkojnë trajtim të menjëhershëm. Kërkesa e parë lidhet me kyçjen dhe funksionalizimin e kanalizimit në fshatrat Llukar, Makoc dhe Grashticë. Ai ka përmendur se gypi i kanalizimit është vendosur, por mungon kyçja në këtë rrjet, gjë që gjatë verës ka shkaktuar probleme të mëdha, pasi shumë shtëpi janë pranë lumit dhe përballen me rreziqe nga përmytjet dhe erozioni, duke shkaktuar paqëndrueshmëri të tokës. Si kërkesë të dytë, ai ka përmendur nevojën për rikonstruktimin e trotuarit që shërben për fëmijët që frekuentojnë shkollën “Ganimete Tërbeshi” dhe shkollën pranë Grashticës. Ky trotuar, i cili më parë ka ekzistuar, është dëmtuar dhe kryetari i ka premtuar se do të bëhej rinovimi i tij përmes një fondi emergjent, por deri tani kjo nuk ka ndodhur. Ai ka theksuar se rruga është magjistrale, me qarkullim të madh dhe lidh Gjilanin përmes Mramurit. Ai ka përmendur edhe një çështje tjetër shumë të rëndësishme që lidhet me shkollën, duke lënë hapësirë për të vazhduar me kërkesat e tjera. Ai ka shpjeguar se rruga pranë shkollës është një rrugë gjarpnore me një kthesë të madhe dhe një nënkallim, të cilat duhet të funksionalizohen. Në veçanti, kalimi i një prurku në atë zonë kërkon pak investim që fëmijët të mos kalojnë rrugën sipër, por të përdorin nënkallimin për siguri më të madhe. Gjithashtu, ai ka përmendur kërkesën e qytetarëve për ndriçim publik në lagjet e Muzliajve, Dikajve dhe Grashticës, pasi disa prej tyre janë pa ndriçim. Një tjetër çështje e veçantë është trajtimi i lumit Prishtevka, i cili kërkon zgjerim dhe pastrim për shkak të vërshimeve që shkaktohen nga reshjet e shumta, duke sjellë probleme për shtëpitë dhe kulturat bujqësore në atë zonë. Ai ka theksuar se ka disa prurje të tjera që ndikojnë në lumenj dhe që duhet të pastrohen gjithashtu. Një problem shumë urgjent, sipas tij, është edhe trajtimi i varrezave, posaçërisht atyre të Dikajve dhe Hamzajve, ku nuk ka më hapësirë të lirë. Për këtë arsye, janë drejtuar më parë te komuna dhe drejtoria, si dhe Agjencisë së Pyjeve, pasi prona e nevojshme i takon kësaj agjencie dhe kryeministrit, që mban përgjegjësi për pronat e saj. Megjithatë, kërkesa për përdorimin e tokës është refuzuar, edhe pse toka është e pashfrytëzueshme dhe pa masë drunore. Ai përfundoi duke thënë se këto janë kërkesa që me vullnet mund të realizohen dhe konkretizohen.

Muhamet Neziri: - i cili tregon se familja e tij ka punuar në perëndim dhe ka blerë prona në Sofali, të cilat nuk kanë mundur t'i shfrytëzojnë aspak. Pronat janë uzurpuar nga ujtësjellësi i Prishtinës, por ata nuk kanë marrë asnjë informacion për to. Ai thotë se kanë bërë padi në gjykatë, por procesi nuk po përparon, me numrin zero zero pesëqind e tridhjetë e thye për zero. Pronat janë të uzurpuara prej tridhjetë e tre orësh dhe nuk ka asnjë mundësi për t'u kontaktuar apo biseduar për to. Ai përmend gjithashtu se ka edhe prona të tjera që ka blerë në perëndim, por nuk ka marrë leje ndërtimi për asnjërën prej katër pronave, duke vështirësuar jetesën. Ai kërkon të dijë informacion në lidhje me numrin e parcelës, pasi posedon fotografi që tregojnë pronën me kanalizim dhe me tridhjetë e tre orë dhe tetë metra. Ai ka bërë kërkesa dhe ankesa, por i është thënë se nuk është përgjegjësi e institucioneve përkatëse, dhe askush nuk po merr përgjegjësi për këtë situatë.

Arbër Sadiki: - ai i këshillon që të drejtohen në Drejtorinë e Planifikimit, duke theksuar se aty ekzistojnë planet digjitale në bazë të numrit të parcelës, të cilat mund t'u tregojnë destinimin e pronës së tyre. Ai supozon se prona mund të ketë destinim publik, për këtë arsye nuk u është dhënë leje ndërtimi. Megjithatë, ai sugjeron që më mirë është të bëjnë një kërkesë për informacion mbi planin në Drejtorinë e Planifikimit. Ai pyet nëse kanë marrë përgjigje dhe thotë se nuk është e pranueshme që t'u thuhet vetëm “nuk është përgjegjësia jonë.” Në përgjigjet e tyre duhet të jetë e shkruar qartë destinimi i pronës. Në rast se prona e poseduar nga ata i përket dikujt tjetër, si një institucion apo ndërmarrje publike, mënyra e zgjidhjes së situatës është çështje tjetër. Ai theksoi se është obligim i tyre t'ua tregojnë destinimin e pronës

sipas planit dhe i këshillon që të paraqesin kërkesën për informacion në Drejtorinë e Planifikimit në Komunën e Re, në katin e katërt. Ai ofrohet ta shikojë situatën pas takimit dhe shpjegon se nuk është e mundur të japin përgjigje pa informacion të saktë. Gjithashtu, nuk di se për çfarë kanë aplikuar, nëse kanë aplikuar për diçka tjetër.

Ali Berisha nga fshati Siçevë, Komunë e Prishtinës: - raporton për zhvillimet dhe problemet lokale. Viti i kaluar solli kërkesa për instalimin e kanalizimit në Siçevë dhe fshatrat përreth, por deri tani nuk është realizuar asgjë. Gjatë këtij mandati, janë përmirësuar rrugicat, urat dhe muret mbrojtëse në Siçevë, si dhe është përfunduar ndriçimi në atë zonë. Në Drejtorinë e Arsimit, janë vizituar disa shkolla dhe është përgëzuar puna e drejtuesit, por ka shqetësime për menaxhimin e klasave me numër të vogël nxënësish dhe për planin e veprimit në këtë drejtim. Në Drejtorinë e Transportit, është përmirësuar shërbimi në Gollak, por ka sugjerime për reduktim të transportit në vikend dhe shtim gjatë ditëve të punës, duke u bazuar në kërkesat e shumta për urbanizëm në zonë. Ai theksoi edhe problemin e shkaktuar nga reshjet e 24 prillit, ku mungesa e kanalizimit bëri që lagjja të përmytej. Kërkesat dhe videot janë dërguar te Drejtoria e Investimeve Kapitale për zgjidhje.

Samir Shahini - drejtor i arsimit: - falënderoi për njohjen e punëve të mira dhe ndau një informacion të rëndësishëm lidhur me Siçevën. Ai njoftoi se është pranuar një kërkesë për të organizuar një takim me komunitetin lokal shumë shpejt, ku do të diskutohet e ardhmja e shkollës për shkak të numrit të vogël të nxënësve. Ai ftoi të gjithë të interesuarit, duke përfshirë përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit dhe komuniteti, të marrin pjesë dhe të koordinohen me drejtorin e shkollës "Ganimete Tërbeshe" dhe Dritonin, i cili është përgjegjës për organizimin e takimit. Shahini theksoi se nëse komuniteti vendos që nxënësit të kalojnë në shkollën "Ganimete Tërbeshe", objekti aktual në Siçevë mund të ridestinohet për qëllime tjera. Deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, proceset tjera do të vazhdojnë. Ai përmendi se situata e ngjashme ekziston edhe në fshatrat e tjera të Gollakut, si dhe në Kishnicë, ku komunitetet kërkojnë kalimin e nxënësve në shkolla me mësim të rregullt ditor, çka konsiderohet si një zhvillim pozitiv dhe riafirmim i punës për mësimin ditor në rajon po ashtu mirëpriti pjesëmarrjen e Siçevës në këtë proces.

Isa Rexha- kryetari i Këshillit Lokal të Barilevës dhe Drenovcit:- u prezantua më parë dhe raportoi për kërkesat e shumta lidhur me infrastrukturën. Ai njoftoi se Barileva dhe Drenovci numërojnë rreth 6,537 banorë dhe kanë kërkuar mbi 12 kilometra rrugë në Zhavar. Megjithatë, shumë prej rrugëve të përmendura janë shtruar në vitet 2023 dhe 2024, ndërsa kërkesat tjera mbeten të paqartësuar, pasi nuk ka marrë përgjigje nga Drejtoria për Investime Kapitale lidhur me 36 projekte të pretenduara. Isa përmendi gjithashtu mungesën e banesave në zona të caktuara, si p.sh. në parkun e Lumnicës, ku nuk ka shtëpi dhe theksoi nevojën që infrastruktura të përfshijë zona më të banuara, përfshirë edhe problematikën e parkimit në Drenoc, ku ka vështirësi me vendet për parkim afër zonës kryesore.

Sokol Havolli – drejtor: - duke sqaruar se çështja e kërkesave për infrastrukturë në fshatrat e Prishtinës është e qartë dhe e balancuar në mënyrë proporcionale. Edhe pse secili fshat mund të ketë nevoja për tridhjetë deri në dyzet kilometra rrugë të asfaltuara, administrata e kryeqytetit mundohet t'i trajtojë secilin fshat me peshë të barabartë. Në mandatin aktual, fshati Barilevë ka marrë prioritet, ku gjatë vitit 2023 janë shtruar rrugët, duke reflektuar zhvillimin e mirë dhe përkushtimin e komunitetit të tij. Megjithatë, nuk është e mundur që të gjitha investimet të përqendrohen vetëm në një fshat, pasi ka edhe zona të tjera me nevoja më emergjente. Kërkesat për infrastrukturë vazhdojnë të rriten, përfshirë ndërtimin e trotuareve, qendrave sportive dhe objekteve rekreative, por realizimi i tyre varet nga buxheti dhe kapaciteti i komunës. Prandaj, shpërndarja e fondeve bëhet në mënyrë proporcionale, duke marrë parasysh nevojat e ndryshme të komuniteteve.

Osman Bllaca:- falënderoi drejtorët, si dhe të gjithë qytetarët për pjesëmarrjen aktive. Ai vlerësoi përgjigjet dhe gatishmërinë e treguar gjatë diskutimeve dhe përshëndeti të pranishmit, duke shprehur shpresën për takime tjera në të ardhmen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Diskutimi i përgjithshëm me qytetarë,
26 qershor, 2025
Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	SADUDIN	HASANI	KRYETAR		
2	JETON	BERISHA	KESHILLIT-QEN		
3	FH4CI	LECI	PERNDREKSHIM		
4	FIDAIM	LECI	BARILEVE		
5	DURIM	BERISHA	BARILEVE		
6	RIFAT	GASHI	BRENOC		
7	KUTIM	DELIU	KRYETAR		
8	DLEN	SHAHINI	KRYETAR		
9	GAXI	DOBRTIQI	MATIL-SUGO		
10	Faik Ram	Ram	KRYETARIT KSHILLIT		

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!
Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Elivjeda	Be Be	Perfugjshose		
12	SABEDIN	BERISHA	KSH.L. LLUKA		
13	AYDI ALI	ALI	KSH.L. Kogelb		
14	Aela Musa	Musa	AKF. "Ali Kelmendi"		
15	Korab Korab	Makolli	AKF. "Afriq Gashi"		
16	Harisa Shasivari	Shasivari	"Al. Kelmendi"		
17	Grona Hajzeri	Hajzeri Hajzeri	Tefik Fankar		
18	Altina	Gashi	AKF. "Xhavit Ahmeti"		
19	Nahar	Prmoku	AKF		
20	Noa	Pllana	AKF		
21	Hjalta	Lezi	AKF		
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
-----	-----------	-----------------	---------------	--------	----------------------